



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 845 Prot.

Tiranë, më 10.06 2019

**VENDIM Nr. 156, datë 6.06.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen. Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 6.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Rikonstruksion banese, sanitarizim & çati e shfrytëzueshme konstruksion druri"*, *Lagjja Nr. 2, rruga "Aleksandër Goga", zona arkeologjike "A" Durrës*-subjekti Z. Ramazan Hysen Myrta.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zhvillimin e projektit *"Rikonstruksion banese, sanitarizim & çati e shfrytëzueshme konstruksion druri"*, *Lagjja Nr. 2, rruga "Aleksandër Goga", zona arkeologjike "A" Durrës*-subjekti Z. Ramazan Hysen Myrta, me kushtin e ruajtjes së themeleve ekzistuese dhe moscënimit të territorit.
2. Subjekti Z. Ramazan Hysen Myrta, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti Z. Ramazan Hysen Myrta, duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për fillimin e punimeve. Këto punime sipas fazave të zbatimit të projektit do të monitorohen nga DRKK Durrës, e cila duhet të depozitojë pranë ASHA informacionin në lidhje me to.
4. Në rast të domosdoshmërisë së kryerjes së punimeve të infrastrukturës inxhinjrike, të paparashikuara për projektin e sipërpërmendur, subjekti Z. Ramazan Hysen Myrta duhet të njoftojë zyrtarisht DRKK Durrës dhe ASHA. Ai duhet të lidhë paraprakisht, akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila do të monitorojë në mënyrë periodike ditore kryerjen e këtyre punimeve, si dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARIT  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**